

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Historia e rrallë e 5-vjeçares, nëna përballet me vendimin e pazakontë për të bijën: Po mendoj t'i ngrij ve zët
ADRESA	https://top-channel.tv/2026/09/25/historia-e-rralle-e-5-vjecares-nena-perballet-me-vendi-min-e-pazakonte-per-te-bijen-po-mendoj-ti-ngrij-vezet/
BURIMI	top-channel.tv
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 09:59:01 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	25 shtator 2026, 09:57:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 25 shtator 2026, 09:56:00 UTC → 25 shtator 2026, 09:58:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5e7b2f428ce4d823b32d208ad32605a3c16ea6a3e04c7a6a0fcbca8fd33151b9
TEKSTI	037fa6ff598a5037c5098cb98dc797521a339e492cb86a56e8c0c58da6bdaafc3
PAMJA	801e1246c13d142122c969f6c7d9b9c92b1f9e901cd753d406cfbcfe105d240c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b2796d76e093b2e8d37a7ed59004ac9bad7e0c4d86941f7910382b74f0dcc729
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	5232afb02d0ef3cfba4c89fffc05e27ccc8e2122c3335e6361f8bbb2dc579865
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b2796d76e093b2e8d37a7ed59004ac9bad7e0c4d86941f7910382b74f0dcc729>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

BOTA TË FUNDIT

Historia e rrallë e 5-vjeçares, nëna përballat me vendimin e pazakontë për të bijën: Po mendoj t'i ngrij vezët

25/09/2026 11:57



Një histori e rrallë dhe tronditëse nga Britania e Madhe ka bërë që një nënë të mendojë që tani për të ardhmen riprodhuese të vajzës së saj, e cila nisi shenjat e pubertetit kur ishte vetëm 10 muajshe.

Sienna, sot 5 vjeçe, u diagnostikua me pubertet qendror të parakohshëm (CPP), një gjendje e rrallë në të cilën truri nis shumë herët sinjalet hormonale që aktivizojnë procesin e pubertetit.

41-vjeçarja Sophie Dumas nga Londra, nuk kishte vënë re fillimisht diçka të pazakontë te vajza. Ishte një vizitë rutinë me infermieren e shëndetit që ngriti dyshimet, pasi ajo vuri re se indi i gjoksit të foshnjës ishte i zmadhuar.

Sienna u dërgua te mjekët specialistë dhe iu nënshtrua një sërë ekzaminimesh, të cilat nëna i përshkruan si "jashtëzakonisht shqetësuese". Mjekët kryen analiza hormonale, teste stimuluese, radiografi për të përcaktuar moshën e kockave dhe më pas një rezonancë magnetike për të kontrolluar nëse ekzistonte ndonjë problem në tru.

Rezultatet konfirmuan diagnozën.

"Sienna ishte një bebe e lumtur dhe e shëndetshme", rrëfen Sophie, e cila thotë se në fillim nuk kishte menduar se pamja e vajzës mund të lidhej me një problem hormonal.

Testet hormonale ishin veçanërisht të vështira. Sipas nënës, foshnja u stresua aq shumë gjatë procedurave sa njëra prej venave të saj u kolapsua dhe mjekët u detyruan t'i merrnin gjak edhe nga thembrat.

Për ta qetësuar, Sophie e ushqente me gji gjatë procedurave.

Pas diagnozës, e vogla nisi trajtimin me injeksione të analogëve të GnRH, të cilat bllokojnë përkohësisht hormonet përgjegjëse për pubertetin. Injeksionet kryhen çdo katër javë dhe mjekët kanë parashikuar që trajtimi mund të vazhdojë deri rreth moshës 11 ose 12 vjeç, në varësi të zhvillimit të saj dhe moshës së kockave.

Rezonanca magnetike nuk tregoi ndonjë shkak të dukshëm në tru. Në shumë raste të pubertetit qendror të parakohshëm, veçanërisht te vajzat, shkakun nuk identifikohet.

Gjendja nuk konsiderohet kërcënuese për jetën, por puberteti i hershëm mund të ndikojë në gjatësinë përfundimtare të fëmijës, pasi rritja fillestare mund të përshpejtohet dhe pllakat e rritjes mund të piqen më herët.

Por për Sophie, shqetësimi nuk lidhet vetëm me zhvillimin fizik.

Ajo frikësohet se vajza mund të përballat me tallje, izolim dhe vështirësi emocionale ndërsa rritet. Së fundmi, shokët e klasës kanë komentuar për puçrrat hormonale në fytyrën e saj, duke menduar se ajo kishte lisë të dhenve.

Kryesore



"Ku jemi katandisur!"/ Ish-deputeti Murrizi nxjerr videon e sherrit në Durrës: Ky që e rrahin si gomarin në duhan është shefi i Komisarariatit Krujë

11:47

Plagosja me armë në Lezhë/ Kamerat e sigurisë zbardhin konfliktin, autorët u larguan me makinë, shpallen në kërkim

09:59

Moti 'përmbys' planet e pushuesve, shiu dhe era boshatisin Lungomaren në Vlorë

10:41

Parashikimi i motit/ Dita e sotme sjell reshje, shtrëngata dhe dëborë në zonat malore

07:05

Kuqezinjët nisin misionin e ri në Nations League, të gjitha emocionet live dhe ekskluzivisht në DigitAlb

10:27

Më të lexuarat

Top Story/ "Kërkoj ekspertim të telefonit jashtë Shqipërisë", gazetarja Hoxha zbardh detajet nga seanca me dyer të mbyllura, çfarë deklaroi Vlorë Hyseni në SPAK

"Dumani përzuri Vlorën nga zyra", Murrizi bën deklaratën e fortë në Top Story: E nxori nga qershori i 2025

"Burg, burg", një grup protestuesish përplasen me Çuçin dhe bashkëshorten në kafene, si përgjigjet deputeti i PS dhe Delina Fico

"Ke kaluar nga zyra e Ergysit që u bëre deputete?"/ Ministria Ismaili i përgjigjet fjalës së Berishës në Kuvend: Tek Agasi isha bashkë me Argitën

Bllokohen specat dhe açuget/ Jo vetëm perimet, Shqipëria ka probleme edhe me produktet e detit. Bllokohen në Itali

"Lashë në mes përkthimin e librit të ish-shefit të kundërzbulimit të STAS-it", rrëfimi i Auron Tares: Historia e spiunazhit në Tiranë ia kalon edhe Luftës së Ftohtë

"Po si nuk i fiku njeri radarët për mua moj motër", Kryemadhi batuta dhe ironi për Vlorë Hysenin: Meta i ndizte se kishte hallin e vendit, puthte...

Top Story/ "Mbrotja do jetë arrogante", Vangjeli për deklaratën e Vlorë Hysenit: Po shantazhon njerëzit me pushtet. Pretendimi

Sienna, e cila ende nuk e kupton plotësisht pse është ndryshe nga fëmijët e tjerë, nuk dinte si t'u shpjegonte shokëve situatën.

"Më dhemb shumë si nënë. Askush nuk dëshiron ta shohë fëmijën e vet të mërzhitur për shkak të diçkaje që të tjerët i thonë", është shprehur Sophie.

Tani, ndërsa vajza rritet, nëna po mendon edhe për një çështje shumë më afatgjatë: fertilitetin e saj në të ardhmen.

41-vjeçarja thotë se po shqyrton mundësinë e ngrirjes së vezëve të Siennës, në mënyrë që vajza të ketë më shumë alternativa kur të jetë e rritur, nëse një ditë dëshiron të krijojë familje.

"Kur u diagnostikua, u shqetësova se ndoshta një ditë nuk do të mund të krijonte familjen e saj dhe se zgjedhja mund t'i hiqej", ka thënë ajo.

Megjithatë, kjo është një çështje që familja po e shqyrton me mjekët dhe nuk do të thotë se Sienna do të ketë domosdoshmërisht probleme me fertilitetin. Nëna shpreson se trajtimi hormonal do të ndihmojë në parandalimin e komplikimeve të lidhura me pubertetin e parakohshëm, shkruan **"Daily Mail"**.

Për momentin, Sophie dëshiron që vajza e saj të jetojë sa më shumë si çdo fëmijë tjetër i moshës së saj. Ajo planifikon ta çojë në Disneyland, me shpresën që t'i ruajë sa më gjatë "magjinë e fëmijërisë".

Historia e Siennës ka bërë që Sophie t'u japë edhe një këshillë prindërve të tjerë: të mos injorojnë ndryshimet e pazakonta tek fëmijët dhe të kërkojnë këshillë mjekësore kur kanë shqetësime.

Në rastin e Siennës, ishte pikërisht vëzhgimi i një punonjëseje shëndetësore që çoi në hetimet e mëtejshme dhe në nisjen e trajtimit në një moshë shumë të hershme.

Top Channel

I saj për Agasin, i gënjeshtërt

Akuzohet për përvetësimin e 700 mijë eurove nga Posta Shqiptare, lirohet nga burgu ish-drejtoresha, Elisabeta Mataj

Mesazhi i presidentit iranian për Trump, Pezeshkian: Ne jemi gati për marrëveshje, SHBA duhet të vendosë për fundin e luftës

I Bota »



Protestonte kundër Netanyahu-t para OKB-së, fituesja e çmimit 'Oscar' përfundon në prangat e policisë së Nju Jorkut

25/09 11:14




Darka Trump-Xi mbledh elitat në Shtëpinë e Bardhë/ Të ftuarit e Titanëve të Teknologjisë, Arabella 15-vjeçare dhe dollia simbolike

25/09 10:31



YouTube refuzon marrëveshjen e Metës për sigurinë e fëmijëve: Kemi mekanizmat tanë

25/09 10:15



'Do të preferoja të isha në ferr'/ Britania në zi për vdekjen e 12-vjeçares, dyshohet se po përballej me bullizëm

25/09 10:04



Tragjedi në Gaza, shpërthen droni që po përdornin, vriten dy ushtarë izraelitë

25/09 09:50



Përplasje për zgjedhjet në Brazil/ 31 ligjvënës amerikanë akuzojnë administratën Trump për ndërhyrje

25/09 09:47

Na ndiqni:



I Video »





Top Channel/ Mali i Zi rikthen vizat: "Direktivë" e BE-së, preken qytetarët nga Rusia e Turqia!



Top Channel/ Ina Zhupa reagon për protestën para Kuvendit: Dhuronit goca dhe gra dhe në një...



Top News – Takimet e Ramës në OKB. Fjala në ECAM dhe galaja e këshillit shqiptaro-amerikan



Top News – 'Fatura para kontratës'. PD denoncon pagesën e thesarit për 'Timak Defence'



Top Channel/ Grabitja e 1.5 mln lekëve dhe bizhuterive në Sarandë, TCh siguron pamjet, momenti kur...



Top Channel/ Benzi del nga rruga, përfundon në një biznes të shitjes së makinave, plagosen 2 persona

Lajme

Lajmet e fundit
Politikë
Kronikë
Aktualitet
Ekonomi
Sociale
Video
Top News LIVE

Bota

Opinion
Koment
Kosova dhe Rajoni
Shkencë dhe Teknologji
Auto

Sport

Kombëtarja
Kategoria Superiore
Kategoria e Parë
Premier League
La Liga
Serie A
Shumësportësh
Sport Gossip

Pop News

Showbiz
Lifestyle
Fashion
Shëndeti
Dieta
Receta gatimi

Programe

Big Brother VIP
Përputhen
Shqipëria LIVE
Fiks Fare
Video
Të gjitha programet
Guida TV

Top Channel

Rreth Top Channel
Kontakt
Bileta – Portokalli
Puno në Top Channel
Privacy Policy & Terms of Use
Aksesueshmëria

© Top Channel 2001 - 2026 - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.